



REPUBLIKA E KOSOVËS		KOMUNA E VUSHTRRISE - OPSTINA VUSHTRRI
01 Nr. / Br	93/19	
Nr. i fq. / Br. st	- 2 -	
Data: / Datum	28.03.2019	
VUSHTRRI - KOSOVA		



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA SOLEMNE E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË,
MBAJTUR MË 6 MARS 2019**

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 13:40.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri:
Bahrije Ademi Murati, Basri Menxhiqi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Faton Shabani, Fjolla Ujkani, Gresa Muli, Habibe Gërxhaliu, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Melihate Basholli-Latif, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Qerim Selimi, Sadije Bajgora, Safet Idrizi dhe Ymer Haradinaj.

Munguan: Ali Januzi, Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Arta Ymeri, Fatmire Saraçi, Gentiana Rama, Hysni Gërguri, Mejreme Ismajli, Miljan Bojković, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Rrezarta Krasniqi dhe Teuta Aruçi – Shartari

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, komandanti i Stacionit Policor në Vushtrri, përfaqësuesi i Akademisë Policore në Vushtrri, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

RENDITE

- Shënimi i 21 - vjetorit të “Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”, si dhe i rënies heroike të Komandantit Legjendar Adem Jashari, Familjes Jashari, Dëshmorëve të Kombit dhe të gjithë të rënëve për liri.

Nasuf Aliu, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë - pasi hapi mbledhjen tha se jemi takuar sot në këtë mbledhje solemne të Kuvendit të komunës, e cila është përcaktuar me agjendën e Qeverisë të Republikës së Kosovës, për nder të shënimit të 21-vjetorit të Epopesë së UÇK-së, gjegjësisht rënies heroike të Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij.

Konform nenit 10 të Rregullores të Punës të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, me të cilën rregullohet mbajtja e mbledhjeve solemne po e hapim takimin e sotëm dhe fjalën ia kaloi kryetarit të Komunës së Vushtrrisë z. Xhafer Tahiri.

Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë:


Inderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës z. Nasuf Aliu,
Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë,
Të nderuar përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta, të nderuar ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
Të nderuar familjarë të dëshmorëve dhe martirëve të luftës,
Të nderuar përfaqësues të Policisë së Kosovës, të KFOR-it,
Të nderuar përfaqësues të Bashkësisë Islame të Kosovës,
Të dashur qytetarë të Vushtrrisë e të Republikës së Kosovës,
Zonja dhe zotërinj,
Qytetarë të dashur të Vushtrrisë,

Kjo mbledhje solemne e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë sot, i dedikohet Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe Familjes heroike Jashari. Rruga e popullit të Kosovës drejt lirisë ishte e gjatë dhe shumë e vështirë, por këtë rrugë e ndriçuan me gjakun e tyre dëshmorët e lirisë dhe kryekomandanti legjendar me familjen e tij. Ne sot kujtojmë me përvlësi të gjithë dëshmorët e rënë për liri që sakrifikuani jetën e tyre në altarin e lirisë, por askush nuk sakrifikoi si Mësuesi Shaban Jashari me bijtë e tij, Ademin, Hamzën dhe tërë familjen e tyre që u vranë barbarisht nga forcat serbe në marsin e vitit 1998. Populli shqiptar i Kosovës nuk u ndal asnjëherë duke kërkuar të drejtën e vet për të qenë i lirë dhe i pavarur, ashtu si të gjitha kombet e lira në botë. Sot që jemi të lirë e të pavarur, ne marrim mësimë shembullore nga vepra jetësore e Adem Jasharit dhe e Ibrahim Rugovës. Që të dy, si dhe shumë veprimtarë e ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me veprat e tyre jetësore plotësojnë mozaikun e Kosovës së lirë e të pavarur. Në kohëra të vështira për popullin e atdheun, ata na e dhanë shembullin që duke qenë të bashkuar e duke sakrifikuar nga vetja arrihen qëllime të larta e të drejta. Adem Jashari, bëri kthesën e madhe duke dhënë shembullin më sublim, duke flijuar veten dhe familjen e tij për liri. Ibrahim Rugova e riktheu Kosovën në gjirin e kombeve të lira duke ndërtuar miqësi të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, NATO dhe Bashkimin Evropian. Të dashur qytetarë të Vushtrrisë, Ne jemi me fat që kemi mundësi t'i shërbejmë shtetit tonë të pavarur, Kosovës, atdheut tonë të dashur. Asnjë individ, asnjë grupim politik, fetar ose etnik nuk është më i rëndësishëm se institucionet e republikës sonë. Tani kur i shërbejmë kësaj republike, detyra jonë themelore është që të respektojmë ligjin, të ndërtojmë një shtet të drejtë e të barabartë, me mundësi për të gjithë. Një shtet ku ne e fëmijët tanë kanë një të ardhme të ndritur, një shtet që e bën krenar Adem Jasharin e Ibrahim Rugovën.


Lavdi Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe Familjes Jashari,
Zoti e bekoftë Vushtrrinë, Kosovën dhe popullin e saj!

Mbledhja përfundoi në ora 13:47.

Bastri Duraku


Procesmbajtës

Nasuf Aliu


Kryesues i Kuvendit

